



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:293853

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05487246

C.nr.1853/2021

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Blerim Istrefi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: F.S.K, F.J, H.M, M. A dhe F.S. Sh, që të gjithë nga M, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit me shkrim, L.T av. me seli në P, kundër të paditurës K.M-Drejtoria Komunale e Arsimit, Baza juridike: Kompensim në emër të licensimit, duke vendosur lidhur me lejueshmërinë e marrëveshjes së lidhur në mes të palëve ndërgjyqës në procedurën e Ndërmjetësimit, jashtë seance me dt. 21.03.2024 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET MARRVESHJA JASHTËGJYQËSORE, me numër të lëndës Nd.nr.316/2023, e arritur në Qendrën për Ndërmjetësim në Mitrovicë me datë 26.12.2023, në mes të paditësve: F.S.K, F.J, H.M, M. A dhe F.S. Sh, që të gjithë nga M, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me Bazë juridike: Kompensim në emër të licencimit dhe e njëjta marrëveshje ka fuqinë e titullit ekzekutiv-përmbarues.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarës ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore Mitrovicë, me datë 29.12.2021, kundër të paditurës, me bazë juridike: Kompensim në emër të shujtave.

Qendra për Ndërmjetësimin, e ka njoftuar gjykatën me dt. 26.12.2023, se palët ndërgjyqëse, kanë arritur marrëveshje për këtë çështje kontestimore, duke ia dorëzuar gjykatës marrëveshjen e lidhur në mes tyre.

Gjykata duke ju referuar të cekurave më lartë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 3.3, 411 dhe 412 të LPK, e lidhur me nenin 3, 4, 10 dhe 14 Ligjit për Ndërmjetësim me nr.06/L-009, i cili ka hyrë në fuqi me dt.28.07.2018, ka ardhur në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore duhet të aprovet, pasi plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe e njëjta është dokument përmbarimor, pra paraqet titullit përmbarues.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr. 1853/2021 me dt.21.03.2024

Gjyqtari
Blerim Istrefi

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.